



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1598 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 229 , Datë 13 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.172, datë 05.11.2018, të z.B. M, kundër Prokurorit të Përgjithshëm, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të përgjegjësisë prindërore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga dokumentacioni dhe parashtimet e sjella nga subjekti ankues, z.B. M rezulton se:

Me Urdhërin nr.19, datë 08.12.1995 të Prokurorit të Përgjithshëm është emëruar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Më pas është transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Tropojë e Gjirokastër². Me shkresat e datave 01.04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 12.04.2017 dhe 05.07.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe datë 19.04.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë i është dërguar informacion Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me problematikën e evidentuar gjatë ushtrimit të detyrës së z.B. M në këto institucione. Me Urdhërin nr.104, datë 20.04.2017 “Për

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Kronologjia e transferimeve citohet në faqen 2 të vendimit.

largim nga detyra të oficerit të policisë gjyqësore”, Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në informacionet e marra nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Fier, Gjirokastrë dhe Tropojë, për sjellje jo etike dhe profesionale të z.B. M, e ka liruar atë nga detyra. Ankuesi pretendon se largimi nga detyra ishte i pamërituar dhe i ka shkaktuar dëm të madh atij dhe familjes së tij. Subjekti ankues shprehet se vlerësimet e tij të punës, gjatë 22 viteve kanë qenë “shumë mirë” dhe se gjatë karrierës së tij është transferuar në mënyrë të shpeshtë pa shkak të ligjshëm duke bërë që ai vazhdimisht të ishte larg familjes së tij, duke i mohuar kështu edhe të drejtën e ushtrimit të kujdesit prindëror. Fillimisht z.B. M është emëruar si oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë në vitin 1995 dhe kronologjia e transferimeve të tij ka vijuar si mëposhtë citohet:

- Në Prokurorinë e Rrethit Vlorë, nga viti 1995-2008.
- Në Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë, nga viti 2008-2014.
- Në Prokurorinë e Rrethit Vlorë, nga viti 2014-2015.
- Në Prokurorinë e Rrethit Tropojë, nga viti 2015-2017.
- Në Prokurorinë e Rrethit Fier, për periudhën Janar 2017-Prill 2017.
- Në Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë, për periudhën 4 Prill 2017-20 Prill 2017 .

Z.B. M shprehet se në bindjen e tij, transferimet e shpeshta mund të jenë bërë me qëllim favorizimi ndaj personave të tjerë, por ndoshta edhe për qëllime favorizuese për t’i marrë shtëpinë në Vlorë, e cila ka qenë pronë-shtet, për të cilën ai ka qenë në një konflikt gjyqësor.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminim lidhur me transferimet e tij të shpeshta nga Prokurori i Përgjithshëm, për shkak se e kanë larguar atë nga familja duke bërë të pamundur ushtrimin e kujdesit prindëror ngaj fëmijëve të tij.

Më pas, shprehet ai, është larguar pa asnjë procedurë disiplinore dhe pa motiv të ligjshëm, përmes Urdhërit nr.104, datë 20.04.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Po ashtu, ankuesi kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin e tij nga Prokurori i Përgjithshëm, lidhur me largimin abuziv nga puna, pa asnjë motiv ligjor apo vendim të Komisionit Disiplinor ndaj tij, gjë e cila ka sjellë efekte negative financiare në familjen e tij, pasi është detyruar t’i ndërpresë edhe studimet e larta njërit prej djemve të tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen

familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

- Ankuesi ka patur dijeni për transferimet në çdo rast (referuar zbatimin të urdhërave të transferimit) dhe jemi para situatës *ipso facto*, pasi ai i ka përmbushur personalisht detyrimet ligjore në ushtrim të detyrës, duke respektuar dhe Udhërat respektivë të transferimeve të tij të njëpasnjëshme, gjë që është cituar në faqen 2 të vendimit. Në kontekst të sa mësipër, ***transferimi i fundit ka qenë me datë 20.04.2017, datë dhe kur është larguar nga detyra. Ankesën pranë KMD-së e ka paraqitur në datën 05.11.2018***, pra më vonë se një vit nga marrja dijeni.
- Po ashtu, referuar dokumentacionit të depozituar në dosje rezulton se me datë 28.07.2017, z.B. M ka regjistruar padinë e tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kundërshtuar largimin e tij nga puna. Pra, supozohet që ai, përpara kësaj date ka marrë dijeni për Urdhërin e largimit të tij nga detyra.
- Pra, ***subjekti ankues ka marrë dijeni për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), minimalisht që më datë 28.07.2017, ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 05.11.2018³***, pra më vonë se një vit nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e z.B. M, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...*”.

³ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: *...”Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁴ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje”.*

Duke qenë se ankuesi është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁵, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së z.B. M, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Përgjegjësia prindërore

⁴ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

⁵ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.